



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 26 (827724)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 25 Qershor 2021

Misioni "Resolute Support Mission" në Kabul, Afganistan



Kthehen Kontingjenti VI dhe XIII i Forcave Speciale dhe Këmbësoresë

Trupat e Kontingjentit VI paqeruajtës të Batalionit të Forcave Speciale dhe Kontingjentit XIII paqeruajtës të Batalionit II të Këmbësoresë që morën pjesë në misionin "Resolute Support Mission" në Kabul, Afganistan, më datë 20 qershor 2021, janë kthyer në atdhe pas përm-bushjes së detyrës. "Mirë se erdhët në atdhe!"

- Kthehet Kontingjenti VI paqeruajtës i batalionit të Forcave Speciale dhe Kontingjenti XIII paqeruajtës i batalionit të dytë të këmbësoresë, që morën pjesë në misionin "Resolute Support Mission" në Kabul, Afganistan", -shkruan ministri Peleshi. Ndërsa në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, në mjediset...

» faqe 2

Zëvendësshefe e SHPFA, Manushaqe Shehu merr gradën "gjeneralmajor"

E para grua ushtarake që mban gradën më të lartë në Forcat e Armatosura

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi kontributin e gjeneralmajor Manushaqe Shehut, duke theksuar se ky është një vlerësim për arritjet e saj në karrierë

» faqe 3



BIBLIOTEKA E AFA

Digjitalizim! Por ende nuk ka një program informatizimi



» faqe 4

Këshilli i Ministrave

Aeroporti "Nënë Tereza", aeroport rezervë i Forcave të Armatosura

Më datë 2 qershor, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin "Për caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", si aeroport reserve i Forcave të Armatosura, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme". Vendimi i mësipërm u morë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "i", të nenit 11, të ligjit nr.64/2014...



» faqe 2

Shoqata e Aviatorëve të Shqipërisë

Pilotët Mahmut Hysa dhe Besnik Shahi, shpallen "Nder i Qarkut" Durrës

Paraditen e datës 15 qershor 2021, në ambientet e Pallatit të Kulturës të qytetit të Durrësit, u zhvillua ceremonia e nderimit dhe shpalljes "Nder i Qarkut" Durrës, të dy pilotëve Mahmut Hysa dhe Besnik Shahi, pas vdekjes. Në këtë aktivitet të organizuar nga Këshilli i Qarkut Durrës dhe Shoqata e Aviatorëve të Shqipërisë, morën pjesë prefekti i Qarkut Durrës...

» faqe 2

VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Edhe Ministria e Mbrojtjes kontrollon importin dhe tregtimin e armëve

» faqe 5

HISTORI

Pushtimi i Shqipërisë nga fqinjët gjatë Luftës së Parë Botërore

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

» faqe 14

Shkolla e Biznesit në Universitetin e Çikagos

Mircea Geoana: Samiti i NATO-s ishte moment historik

MSC. MIMOZA GOLIKJA

» faqe 8



Misioni “Resolute Support Mission” në Kabul, Afganistan

Kthehen Kontingjenti VI dhe XIII i Forcave Speciale dhe Këmbësorisë

Ky është kontingjenti i fundit në Afganistan, i cili përmbylli një kapitull krenarie për Forcat e Armatosura në operacionet e mbështetjes së paqes, të udhëhequra nga NATO

Trupat e Kontingjentit VI paqeruajtës të Batalionit të Forcave Speciale dhe Kontingjentit XIII paqeruajtës të Batalionit II të Këmbësorisë që morën pjesë në misionin “Resolute Support Mission” në Kabul, Afganistan, më datë 20 qershor 2021, janë kthyer në atdhe pas përmbushjes së detyrës.

“Mirë se erdhët në atdhe!” - Kthehet Kontingjenti VI paqeruajtës i batalionit të Forcave Speciale dhe Kontingjentit XIII paqeruajtës i batalionit të dytë të këmbësorisë, që morën pjesë në misionin “Resolute Support Mission” në Kabul, Afganistan”, - shkruan ministri Peleshi.

Ndërsa në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, në mjediset ushtarake të Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas, morën pjesë zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe atashu ushtarak i Republikës së Turqisë kolonel Muhammet Kelami Kablay, si dhe familjarët e efektivëve.

Në fjalën e tij, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji theksoi: “Nga ky vend ku jemi mbledhur, kemi përcjellë dhe pritur shumë kontingjente ndër vite, por ky i sotmi është më i veçantë. Ju jeni kontingjenti i fundit në misionin paqeruajtës RSM duke përmbyllur një tjetër kapitull historik krenarie të kontributit të Forcës Tokësore në operacionet e mbështetjes së paqes, të udhëhequra nga NATO. Eksperiencën e përfutur është një mundësi e shkëlqyer, ku mësimet e nxjerra do t’i përdorim në të ardhmen në trajnim, edukim dhe stërvitje.”

Ky mision ka qëndruar për 6 muaj



në Afganistan. Ai u nis nga Shqipëria të martën, më 8 dhjetor 2020, ku ishte i pranishëm Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjeneralmajor Bajram Begaj. Misioni VI i Resolute Support Mission në Kabul

është kontingjenti i fundit që shërben në Afganistan. Forca Tokësore që në fillimet e pjesëmarrjes në misionet ndërkombëtare në Afganistan në 2002 është përfaqësuar në të gjitha komandat rajonale si Herat, Mazar-i-Sharif, Kabul dhe Kandahar.

BATALIONI I XHENIOS



Ndërtohet ura për 3400 banorë e cila do lidhë 7 fshatra

P prej disa ditësh specialistët e kompanisë së urave të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse ndodhen në Njësinë Administrative Dermenas të Bashkisë Fier, ku po vijojnë punimet për ndërtimin e urës bailey me gjatësi 12m, seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 20 ton. Ndërtimi i kësaj urë i shërben një komuniteti prej rreth 3400 banorësh. Kjo urë lidh 7 fshatra: Povelce, Rrethfik, Darëzezë, Boçovë, Pojan, Sop, Kryegjatë. Kjo bën të mundur lidhjen e 7 shkollave 9-vjeçare dhe qendrave shëndetësore, duke iu mundësuar lehtësi në lëvizje për banorët. Për ndërtimin e kësaj ure janë angazhuar, 16 specialistë të togës së urave, si dhe 6 mjete. Është realizuar me sukses ndërtimi i kësaj ure kaq të rëndësishme për banorët e kësaj zone.

KËSHILLI I MINISTRAVE

Aeroporti “Nënë Tereza”, aeroport rezervë i Forcave të Armatosura

Më datë 2 qershor, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin “Për caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”, si aeroport reserve i Forcave të Armatosura, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme”. Vendimi i mësipërm u morë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “i”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Mbi bazën e këtij ligji me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave, caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”, si aeroport rezervë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë gjendjeve për



të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastruk-

turës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

EKSPERTËT E XHENIOS



Demontohen predhat e gjetura nga Lufta e Dytë Botërore

Janë demontuar predhat e Luftës Dytë Botërore. Disa predha luftarake që mendohet se i përkasin periudhës së Luftës së Dytë Botërore janë gjetur gjatë punimeve përgjatë lumit Gjanica në qytetin e Fierit. Predhat janë gjetur pranë disa banesave në afërsi të Urës së Sheqit. Punonjësit që kryejnë punimet për sistemin e brigjeve të lumit Gjanica dhe rehabilitimit të këtij segmenti pasi kanë parë predhat, kanë njoftuar menjëherë Policinë e Shtetit, e cila ka njoftuar edhe Ministrinë e Mbrojtjes. Nga ekipet speciale të Ministrisë së Mbrojtjes janë marrë masat përkatëse duke respektuar procedurat e zhvendosjes së predhave për të vijuar më pas me demontimin e tyre.

Zëvendësshefe e SHPFA, Manushaqe Shehu merr gradën “gjeneralmajor”

Në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ditën e martë, më 22 qershor 2021, ceremonia e gradimit të zëvendësshefes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Manushaqe Shehu me gradën “gjeneralmajor”.

Ajo është e para grua ushtarake që mban gradën më të lartë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë.

Gjatë ceremonisë, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi kontributin e gjeneralmajor Manushaqe Shehut, duke theksuar se ky është një vlerësim për arritjet e saj në karrierë. Ministri Peleshi vuri në dukje detyrat e rëndësishme që ajo ka kryer, përfshirë këtu edhe detyra me rëndësi sensitive.

Zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, falënderoi autoritetet e larta të Shtetit për vlerësimin e dhënë, duke premtuar se do të punojë me përkushtim e profesionalizëm që t'i shërbejë Forcave të Armatosura dhe vendit me mbështetjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi. Ajo u bëri thirrje grave dhe burrave nën uniformë se me punë të palodhur dhe përkushtim mund të promovohen në gradë.

“Shërbimi në FA është sa i vështirë, sakrificë, delikat aq dhe i bukur. E themi këtë për të bërë apel cdo ushtaraku burra apo gra, djem dhe vajza që puna e palodhur, përkushtimi, komunikimi me

E para grua ushtarake që mban gradën më të lartë në Forcat e Armatosura

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi kontributin e gjeneralmajor Manushaqe Shehut, duke theksuar se ky është një vlerësim për arritjet e saj në karrierë



eprrorët dhe vartësit është mundësia për të përmbushur objektivat dhe promovuar në gradën e radhës”, tha Gjeneralmajorë Shehu.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu është titulluar oficer në vitin 1984 dhe në karrierën e saj të gjatë prej 37 vjetësh në uniformë ka shërbyer në disa detyra

dhe funksione.

Më 14 nëntor 2016 ajo u gradua “gjeneral brigade”, me dekret të presidentit të Republikës Bujar Nishani,

Zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, falënderoi autoritetet e larta të Shtetit për vlerësimin e dhënë, duke premtuar se do të punojë me përkushtim e profesionalizëm që t'i shërbejë Forcave të Armatosura dhe vendit me mbështetjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi.

ndërsa tashmë ajo mban gradën më të lartë “general major”, me dekret të presidentit të Republikës Ilir Meta, Nr. 13113, datë 17 qershor 2021.

Kush është Gjeneralmajorë Manushaqe Shehu

Gjeneral majorë Manushaqe Shehu ka lindur në Peshkopi më 5 nëntor të vitit 1965. Pas përfundimit të studimeve në Akademinë e Lartë të Oficerëve në Tiranë në vitin 1984-1988, emërohet Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900, Peshkopi. Gjatë viteve 1989-1994, përfundon Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës. Në vitin 1991 merr gradën Kapiten i Parë. Nga viti 1989-1996, kryen disa detyra të ndryshme në Logjistikë si itendente batalioni, shefe e shërbimeve të ndryshme logjistike për ushqimin, veshmbathjen, karburantin e kazermimin në brigadë, deri shefe e Logjistikës e Divizionit 1100, Shkodër. Në vitin 1996 emërohet Specialiste e Kontrollit Financiar dhe Rezervave të Paprekshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë detyrë e mban deri në mars të vitit 2000. Gjatë viteve 2000-2002 punon në ekipin amerikan të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si përkthyes, njëkohësisht kryen studime pasuniversitare (Kursin Themelor të

Oficerit në SHPFA dhe Kursin e Funksioneve) në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2003 merr gradën Major dhe emërohet Shefe e Shërbimit të Ushqimit në FA, detyrë që e mban deri në vitin 2004. Gjatë kësaj periudhe, ka qenë nismëtare e disa projekteve të



ristrukturimit të FA dhe anëtare e Bordit të Kompanisë Amerikane SAIC “për ndryshimin e strukturave të FA”, si dhe anëtare e bordeve drejtuese të ndryshimit të disa rregulloreve të ndryshme për Logjistikën në FA. Drejtuese e Bordit të Ndryshimit të Normave të Ushqimit dhe Veshmbathjes e Kazermimit në FA. Në vitet 2004-2005 përfundon

ADAMS P&P (shkollë logjistike) në Tur, Francë dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm “Spiro Moisiu”, Tiranë. Në vitin 2006 merr gradën Nënkolonel dhe emërohet Shefe e Furnizimit të FA dhe në vitin 2007, Shefe e Protokollit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Më 8 tetor 2007 emërohet Ndihmëse e Presidentit të Republikës, për Çështjet

Ushtarake dhe Integrimin Euroatlantik. Gjatë kësaj periudhe përfundon studimet në Kolegjin e Lartë Rajonal të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2010 përfundon Master Shkencor të Nivelit të Dytë (MND) në fushën e Sigurisë Kombëtare dhe merr gradën “Kolonel”. Më 4 shkurt 2011 emërohet Këshilltare Ushtarake

e Presidentit të Republikës. Me 1 shtator 2012 emërohet Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes. Pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s. Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu ka qenë pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s, aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake e civile të FA dhe të rajonit. Gjatë karrierës së saj, ka qenë nismëtare e një sërë projektesh të përbashkëta civilo-ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një vend të veçantë zënë projektet për barazinë gjinore, për të cilat ka marrë mirënjohje dhe falënderime nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por edhe nga shoqëria civile e strukturat e tjera të kontrollit civil në Forcat e Armatosura.

Më 1 nëntor 2016 emërohet Komandante e Akademisë së Nënoficerëve. Më 14 nëntor 2016 gradohet “Gjeneral Brigade”, e para ushtarake femër në historinë e Republikës së Shqipërisë që merr këtë gradë. Më 1 dhjetor 2016 emërohet në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Aktualisht mban vendin e zëvendësshefes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Biblioteka e Akademisë së Forcave të Armatosura

MSC NAFIE LALA
HAJRIE DEDAJDigjitalizim! Por ende nuk
ka një program informatizimi*Fondi i bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura përmban 8.847 tituj
(46.848 kopje), por për momentin ende nuk ka një program informatizimi*

S i një vatër e dijes dhe kulturës, bibliotekat luajnë një rol themelor në shoqëri. Burimet dhe shërbimet që ato ofrojnë krijojnë mundësi për të mësuar, mbështesin shkrim-leximin dhe edukimin, ndihmojnë në formësimin e ideve dhe perspektivave të reja që janë thelbësore për një shoqëri krijuese dhe inovative. Bibliotekat janë sinonim i arsimit dhe ofrojnë mundësi të panumërta për të mësuar, mund të ushqejnë zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Libri është postieri i dijes në mendjen e gjithsecilit. Fjala ‘fuqi’ ka qenë e lidhur për një kohë të gjatë me forcën muskulore, kurse fjala ‘njohuri’ ka qenë gjithmonë e lidhur me mendjen. Dekadat e fundit fuqia botërore ka pësuar një transformim të jashtëzakonshëm. Nëse vite më parë forca tregohej në një fushëbetejë dhe më shumë rëndësi kishte forca fizike sesa ajo mendore, sot fuqia e penës është më e fortë se shpata.

Vendi ynë ka një trupë ushtarakësh, oficerësh, nënoficerësh punonjës civilë, që marrin shërbimin e nevojshëm pranë Bibliotekës së Akademisë të Forcave të Armatosura. Biblioteka e Akademisë që prej 10 majit të 1958 ka qenë pjesë e Akademisë Ushtarake. Në vitet e saj të para fondi i bibliotekës ishte kryesisht literaturë ushtarake mësimore, botime të Akademisë së ushtarakëve, leksione, dispensa metodike, plan seminare, rregullore, manuale të Ministrisë së Mbrojtjes sigurisht edhe libra artistik. Biblioteka vijon të pasurohet me libra, botime periodike ushtarake në gjuhë të huaj apo botime shkencore. Në vijim do të njiheni në vija të përgjithshme me mënyrën sesi është e organizuar, procesin e klasifikimit të librave, pasurimin e saj me literaturë, apo rrugën që biblioteka e Akademisë është duke bërë drejt digjitalizimit.

Fondi dhe rrugët e pasurimit të bibliotekës

Biblioteka pasurohet në mënyrë të vazhduar me literaturë, duke bërë të mundur që secili lexues të ketë mundësinë të ketë në dispozicion dhe të punojë me materialet që ai kërkon. Ajo pasurohet rregullisht me libra,

botime të Tipografisë Ushtarake, botime nga shtëpitë botuese të ndryshme, blerje të literaturës së huaj në rusisht, anglisht, italisht, frëngjisht dhe serbo-kroatisht. Ne 2006 fondi i bibliotekës numëronte 1400 tituj (7000 kopje), kurse sot fondi i bibliotekës përmban 8847 tituj (46848 kopje) nga të cilat: Fondi i literaturës ushtarake 1000 tituj (14437 kopje); Fondi i literaturës shqip jo ushtarake 4657 tituj (21306 kopje); Fondi i literaturës në gjuhë të huaj 2860 tituj (7305 kopje); Fondi i periodikut (revista, gazeta, buletine) 30 tituj (2300 kopje), Fondi i leksioneve, disertacioneve dhe temat e studenteve master shkencor dhe profesional 300 tituj (1500 kopje),

Fondi i enciklopedive (britanike, franceze, italiane, ruse, greke, jugosllave etj.) të cilin e përmendim edhe si fondin më me vlerë, 23 tituj, fondi i bibliografive 10 tituj. Pasurimi me literaturë në bibliotekën e Akademisë realizohet disa herë gjatë 1 viti. Pasurimi është i përhershëm sidomos me literaturë ushtarake, botimet

e akademikëve, botime të kërkimit shkencor në Akademinë e Forcave të Armatosura, botime të Ministrisë së Mbrojtjes, sigurisht dhe me blerjet që bëhen, por dhe me dhurata nga institucione siç ishin ato të Akademisë së Shkencave, ku në tetor 2020 dhuroi 220 tituj, botime të saj. Para se të kalojë në dorën e lexuesit literatura përshkon një proces të gjatë të përpunimit sipas rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik dhe klasifikimit. Proceset janë: vulosja e çdo njësie bibliotekare, regjistrimi në librin e inventarit, skedimi i çdo titulli të literaturës, vendosja e etiketës me nr. e adresës në raft të çdo njësie dhe së fundmi, por jo më pak i rëndësishmi është klasifikimi (studimi nga ana shkencore) sipas KDU Klasifikimi Dhjetor Universal.

Klasifikimi i librit

Klasifikimi është akti i organizimit të universit të dijeve sipas një renditje

sistematike. Klasifikimi ndihmon në gjetjen e vendndodhjes së materialit, ndihmon përdoruesin të mendojë për aspektet me të cilat ka lidhje kërkimi. Me anë të klasifikimit mundësohet dhënia e informacionit për më shumë se një subjekt të caktuar.

Seleksionimi kryhet duke u bazuar në ligjin për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë nr. 8576 datë 03.02.2000. Seleksionimi kryhet duke u bazuar në: gjendjen fizike të literaturës; vjetërsinë e materialeve; përmbajtjen; sasinë e kopjeve. Në të gjitha rastet ruhet “kopja arkiv”. Ndodh që lexuesit të jenë të paqartë për informacionin që kërkojnë dhe për këtë arsye biblioteka ndërton mjetet e saj të kërkimit të informacionit siç janë:

Skedarët (katologët manual) janë një përmbledhje e skedave të cilat përveç përshkrimit bibliografik fizik përmbajnë edhe numrin e klasifikimit. Mbi bazën e numrit të klasifikimit vendosen edhe skedat në skedar ku përfshihen të gjitha fushat e dijes.

Digjitalizimi në Bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura

Fytyra e bibliotekave po ndryshon ndërsa përmbajtja po lëviz drejt një platforme digjitale dhe aksesit në internet po bëhet gjithnjë e më i madh. Tashmë është një domosdoshmëri njerëzore më shumë sesa një privilegj. Ndërsa interneti bëhet pjesë e jetës sonë, digjitalizimi mbetet një nga sfidat më të rëndësishme për bibliotekat në Shqipëri. Ka vite që po flitet për finalizimin e projektit të digjitalizimit në Bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe mbase një ditë ky finalizim do të arrihet. Me akreditimin

nga Qeveria në mbledhjen datës 19 shkurt 2020, të Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm i arsimit të lartë ushtarak, edhe biblioteka e Akademisë së Forcave të Armatosura merr një rëndësi edhe më të madhe me prioritet pasurimin me literaturë dhe informatizim në mënyrë që literatura të gjendet online me gjithë informacionin që ka biblioteka. Për momentin ende nuk ka një program informatizimi, dhe në momentin që do të vendoset ky i fundit çdo material i bibliotekës do të jetë online. Biblioteka digjitale do të shërbejë për të gjithë personelin ushtarak, apo civil qoftë ai, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, ku nëpërmjet internetit do të shërbehen disa kategori librash ushtarakë, filozofikë dhe artistikë. Sigurisht, që pas tyre do të gjenden online dokumentacione, udhëzime dhe direktiva. Është shumë e rëndësishme të digjitalizohen materialet me vlerë, që rrezikojnë të shkatërrohen fizikisht, pasi mund të jenë qindra vjeçare.

Informatizimi i bibliotekës mbetet ende një nga sfidat më të mëdha për bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura. Sipas ligjit nr. 8576 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” çdo person ka të drejtën e marrjes së informacionit pa dallim moshe, gjinie, race, feje, bindjeje. Biblioteka e AFA-së i shërben jo vetëm AFA-së, por të gjithë Forcave të Armatosura dhe më gjerë. Sipas rregullores së brendshme të bibliotekës shërbehet jashtë bibliotekës 1-3 njësi bibliotekare me kohëzgjatje nga 2-3 javë për librin shqip dhe deri një muaj për librin e huaj. Kopja e vetme dhe disertacionet nuk lejohen të dalë nga biblioteka, por shërbehen në sallat e leximit. Fotokopjimi i materialeve bibliotekare bazohet në rregulloren e bibliotekës.

Punonjësit e Bibliotekës së Akademisë janë trajnuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, sigurisht, që nga ana profesionale zhvillohen edhe shumë bashkëpunime e konferenca të përbashkëta. Biblioteka Kombëtare është ajo, që mbetet vendimmarrëse nga ana profesionale kundrejt gjithë bibliotekave të tjera në vend, pra edhe kundrejt Bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura. Tashmë hapësira e Bibliotekës së AFA-së ka një sipërfaqe prej 650 m2, me dy salla fondesh, dy salla leximi me 25 vende, sallë interneti me 12 vende, sallë leksionesh. Biblioteka e Akademisë duke pasur një profil ushtarak mbetet streha e së kaluarës, e së tashmes dhe e së ardhmes për sa i përket kulturës ushtarake.



Vendim i Këshillit të Ministrave, datë 12 maj 2021

Edhe Ministria e Mbrojtjes kontrollon importin dhe tregtimin e armëve

“Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe rregjistrimit të shtetasve shqiptare dhe të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në teritorin e Republikës së Shqipërisë”

Më datë 12 maj, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin “Per disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.348, date 29.4.2015, te Këshillit të Ministrave, “Per procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe rregjistrimit të shtetasve shqiptare dhe të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në teritorin e Republikës së Shqipërisë”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 7, të nenit 9, të ligjit nr.74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave ka vendosur në vendimin nr.348, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I, “Regjimi për hyrje/daljet dhe regjistrimin e armëve në teritorin e Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa: a) Shkronjat “a”, “c”, dhe “ç”, të pikës 2, ndryshohen, si më poshtë vijon: “a) Licencë për import dhe tregtim të armëve të kategorive “C” (gjahut), pjesëve kryesore dhe municionit të tyre të lëshuar nga Komisioni Qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose licencë për import/eksport, ndërmjetësim, transit, për armët e kategorive “B”, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre të lëshuar nga struktura përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes. c) Licencë të lëshuar nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, për import/eksport të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre. ç) Dokumentin e blerjes së armëve, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre.



Armët regjistrohen me numra serialë, numrat serialë të pjesëve kryesore, tipin, kalibrin, modelin shtetin prodhues dhe fabrikën e prodhimit.”. b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon: “6. Në rastet kur punonjësi i policisë kufitare, gjatë kontrollit fizik, gjen armë, pjesë të armëve dhe municion, të cilat subjekti i licencuar, person fizik ose juridik, nuk i ka në inventarin shoqërues autorizimit të importit ose ato janë armë dhe municione që nuk përfshihen në autorizimin e importit ose kanë numra të ndryshëm serialë nga ato në autorizim, punonjësi i policisë/doganës duhet të sekuestrojë armën dhe municionin. Ai njofton vendin e eksportit/importit që të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të ndryshojë autorizimin, duke përditësuar inventarin shoqërues ose të tërheqë armën, pjesën e armës ose municionin që nuk është në inventarin fizik shoqërues, pas kryerjes së veprimeve procedurale penale në shtetin e origjinës ose shtetet ku kanë kaluar transit. Armët, pjesët e armëve dhe municionet, të cilat nga kontrolli fizik rezultojnë se nuk kanë një numër serial, sekuestrohen nga autoritetet pas kryerjes së veprimeve procedurale penale të nevojshme nga punonjësi i policisë kufitare dhe tërhiqen më pas nga vendi i eksportit.”.

2. Titulli i kreut të dytë ndryshohet dhe bëhet “Procedurat e markimit të armëve të zjarrit”.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: “9. Për kategorinë “B” dhe “C” të armëve dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë duhet të kenë të shënuar një markim të dukshëm, të përhershëm dhe unik. Markimi unik përfshin emrin e prodhuesit, ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë, vitin e prodhimit dhe modelin nëse nuk është pjesë e numrit të serisë. Markimi është detyrim i subjektit të licencuar për import/eksporti të armëve të zjarrit, pjesëve

nëse vendoset në një pjesë metalike, dhe të paktën 0,3 mm nëse realizohet në një pjesë polimer.”.

7. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon: “12. Markimi vendoset në pjesën kryesore të dukshme të armës së zjarrit dhe në pjesët kryesore të armëve. Markimi duhet të jetë i pazëvendësueshëm në asnjë rrethanë.”.

8. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon: “13. Subjektet e licencuara sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, janë përgjegjëse për markimin e armëve të zjarrit të kategorisë “B”, të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë. Markimi i armëve të kategorisë “B” dhe pjesët kryesore realizohet në vendin e origjinës nga ku importohen dhe duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara sipas pikave 11 dhe 12, të këtij vendimi. Standardet e përcaktuara sipas pikave 11 dhe 12, të këtij vendimi, kontrollohen në pikën e kalimit kufitar nga Policia e Shtetit. Armët që nuk përmbushin standardet e markimit sekuestrohen.”.

9. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon: “14. Procedurat e markimit nuk aplikohen: a) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre të importuara nga vendet e BE-së, nëse nga shteti eksportues janë markuar; b) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat importohen ekskluzivisht për qëllime kërkimore. Në këtë rast armët markohen me inicialet

“LB”; c) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat lëvizin transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë; ç) për armët e zjarrit të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore (armë zjarri antike).”.

10. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon: “15. Procedurat e markimit u nënshtrohen edhe armët e zjarrit që çaktivizohen. Markimi i armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre bëhet nga subjekte shtetërore të licencuara për çaktivizimin e armëve të zjarrit. Modeli i markimit unik të çaktivizimit është: EU(1) Aa(2) bb(3) c(4). (1): Vendoset në fillim të markimit për të gjitha vendet e BE-së; (2): Shteti që kryen çaktivizimin; (3): Simboli i strukturës që kryen çaktivizimin; (4): Viti kur është kryer çaktivizimi.”.

11. Pika 16 shfuqizohet.

12. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon: “17. Armët e zjarrit të markuara sipas procedurave të pikës 15, të këtij vendimi, para se të jepen për përdorim kontrollohen nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit. Për të gjitha armët jepen certifikatat e markimit. Nuk lejohet të jepen për përdorim armët e zjarrit të pamarkuara.”. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes dhe ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VENDIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Detarët që përfitojnë nga indeksimi 2.7 % i pensioneve

Këshilli i Ministrave, datë 31 mars 2021 miratoi vendimin “per indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”, ku indeksimi, në masën 2.7 për qind, përfitojnë krahas kategorive të tjera edhe pensionet e caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji. Përfitojnë familjet e pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar. Gjithashtu përfitojnë edhe ata që kanë trajtime të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare në pension”. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, brenda një muaji nga data e miratimit të vendimit, duhet të hartojë dhe të dërgojë për botim në “Fletoren zyrtare” tabelën e koeficientëve progresivë të indeksimit të bazës së vlerësuar të arritur nëpërmjet kontributeve të derdhura për periudhën kontributive deri në vitin 2021, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2021.

Miratohet Stema dhe Flamuri i Agjencisë Inteligjencës së Mbrojtjes

Më datë 31 mars 2021, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin “Për përcaktimin e Stemës dhe të Flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”. Kjo u në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”. Me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e stemës dhe të flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi. Stema dhe flamuri dekorativ i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për nga qëllimi i përdorimit, i përkasin vetëm strukturës së kësaj agjencie. Ndalohet shumëfishimi, imitimi dhe përdorimi i tyre nga institucionet apo subjektet e tjera, që, sipas ligjit, përdorin uniformë. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.



Qendra e Personel Rekrutimit

Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistikë (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakulteti e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përfundim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi beachelor) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjisllacionit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënofficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të



mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënofficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandim për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumen-



tacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit: kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;

fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar

Datat e testimit:

Datat e testimit për aplikantët janë përcaktuar si vijon: testi i gjuhës së huaj (anglisht) është më datë 10.08.2021, testi fizik është më datë 11.08.2021, testi intelektual është më datë 12.08.2021 dhe testi psikologjik është më datë 12.08.2021.

Shenim: Aplikanti deklaron dhe firmos se të dhënat e paraqitura në formularëtpërkatesjanë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



Shoqata e Aviatorëve të Shqipërisë

Pilotët Mahmut Hysa dhe Besnik Shahi,
shpallen "Nder i Qarkut" Durrës*Mahmut Hysa dhe Besnik Shahi janë një nder e krenari e veçantë për ne, komunitetin ushtarak të Forcës Ajrore*

Paraditen e datës 15 qershor 2021, në ambientet e Pallatit të Kulturës të qytetit të Durrësit, u zhvillua ceremonia e nderimit dhe shpalljes "Nder i Qarkut" Durrës, të dy pilotëve Mahmut Hysa dhe Besnik Shahi, pas vdekjes. Në këtë aktivitet të organizuar nga Këshilli i Qarkut Durrës dhe Shoqata e Aviatorëve të Shqipërisë, morën pjesë prefekti i Qarkut Durrës z. Roland Nasto, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, kryetari i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, familjarë të dy pilotëve si dhe pilotë e ushtarakë të Forcës Ajrore.

Pas fjalëve të rastit të mbajtura në ceremoni nga prefekti i Qarkut Durrës, kryetari i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë, kolonel Ylli Pulaj shprehu kënaqësinë që ishte prezent në këtë ceremoni duke theksuar se "Shpallja "Nder i Qarkut" Durrës të Mahmutit dhe Besnikut është nder jo vetëm të komunitetit të Maminasit dhe Shijakut ku ata lindën, u rritën dhe u edukuan, por ky është edhe një nder e krenari e veçantë edhe për ne, komunitetin ushtarak të Forcës Ajrore, pjesë e së cilës ata kanë qenë dhe që shpesh ne e quajmë këtë komunitet "Vëllezër dhe motra në uniformë", pasi kështu jemi, si një familje e vetme dhe kjo na bën që sot të jemi më të nderuar dhe krenarë".

Zëvendëskomandanti i Forcës



Ajrore në mënyrë të përmbledhur foli për kontributin e dy pilotëve të cilët, vlerësoi ai ndër të tjera, "kanë qenë jo vetëm pilotë të talentuar por dhe drejtues të zotë. Kudo ku ata kanë studiuar brenda dhe jashtë vendit kanë qenë modeli dhe përfaqësia më e mirë e ushtarakut shqiptar".

Në fund të fjalës së tij, kolonel Pulaj shprehu mirënjohjen për iniciativën e Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë dhe Qarkut të Durrësit për këtë vlerësim të lartë që po ju bëjnë dy ish-anëtarëve të komunitetit dhe familjes sonë të madhe të Forcës Ajrore, pasi tashmë ata nuk janë vetëm nderi dhe krenaria

e Forcës Ajrore por dhe krenaria e Qarkut të Durrësit.

Ceremonia vijoi me dorëzimin e titujve "Nder i Qarkut" familjarëve të pilotëve, Sekretari i Këshillit të Qarkut dhe Certifikatat e Mirënjohjes për dy pilotët pas vdekjes dorëzuar nga Shoqata e Aviatorëve të Shqipërisë.

Në fund përshëndetën pjesëtarë të familjeve të pilotëve Hysa dhe Shehi, të cilët shprehën kujtimet prekëse për prindërit e tyre dhe falënderuan autoritetet e qarkut Durrës dhe shoqatën e Aviatorëve të Shqipërisë si dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë ceremoni.

VKM: MINISTRIA E MBROJTJES

"Objekti Nr.38" kalon me
përdorim të Drejtorisë e Arkivave

Këshilli i Ministrave, miratoi më 9 qershor 2021, vendimin Nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministri së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërbllim, nga Ministria e Mbrojtjes të Drejtorisë e Përgjithshme e Arkivave, të komponentit "Objekti Nr.38", pjesë përbërëse e pronës me numër rendor 1332, me emërtimin "Ish-Shtabi i Brigades", pjesë e pasurisë 201/84, ndodhur në zonën kadastrale 8541, Gjirrokastër".

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e vijues, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 11 e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave vendosi:

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e komponentit "Ob-



jekti nr.38", pjesë përbërëse e pronës me numër rendor 1332, me emërtimin "Ish-Shtabi i Brigadës", pjesë e pasurisë 201/84, ndodhur në zonën kadastrale 8541, Gjirrokastër, ndryshohen sipas përmasave të përcaktuara në planrilevimin e planimetrit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërbllim, për një periudhë 7-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes të

Drejtorisë e Përgjithshme e Arkivave, për ushtrimin e funksioneve administrative. Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtorisë e Përgjithshme e Arkivave të lidhin marrëveshje për dhënien në përdorim, pa shpërbllim, të pronës, sipas pikës 1, të këtij vendimi. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Drejtorisë e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare"

KËSHILLI I MINISTRAVE

Miratohet vendimi për aktivitetet
ushtarake të NATO-s dhe Aleatëve

Qeveria në mbledhjet e vet të datës 22 qershor 2021, miratoi vendimin "Për miratimin në parim, të notës së aderimit/deklarimit të synimit, për tu bërë pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Malit të Zi dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe shtabit të Komandës Supreme Aleate për transformimin, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit prites për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve të organizatës të Traktatit të Atlantikut verior".

Vendimi është marrë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i

Ai gjithashtu, njoftoi me angazhimet dhe hapat e deritanishëm të Qeverisë në përgjithësi dhe Ministrisë në veçanti, në funksion të zhvillimit dhe avancimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale të nevojshme, bazuar në prioritetet e Qeverisë dhe qëllimeve strategjike të tij, me orientim kryesor në profesion-



alizim dhe modernizim të forcave për ndërveprueshmëri të plotë dhe zgjerim të gamës së operacioneve jashtë vendit përkrahë forcave amerikane dhe aleatëve tjerë. Ai u zotua se të gjitha angazhimet e tyre stërvitore e operacionale do të kenë mbështetjen e tij të plotë dhe se, si ushtarak do të ketë me prioritet mirëqenien e ushtarakëve, pajisjen, stërvitjen dhe specializimet

adekuate të tyre për shërbim të bazuar në standardet dhe vlerat më të larta të ushtrive të vendeve të NATO-s. Më pas, ministri me delegacionin e tij dhe stafin komandues të regjimentit, bënë homazh në Memorialin Përkujtimor të Gjilan, ku nderoi veprën dhe sakrificën e të gjithë heronjve dhe dëshmorëve të kombit në këtë ditë që përkon edhe me Ditën e Çlirimit të Gjilanit me rrethinë.

Qendra e Studimeve Universitare

Ministri Mehaj inspekton stërvitjen fushore “Kampi i Avancuar 2021”

Kapacitet e shkollimit ushtarak në të gjitha nivelet do të jenë sipas standardeve më të avancuara të vendeve të NATO-s

Me qëllim të njohjes nga afër me nivelin e demonstrimit profesional, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj i shoqëruar nga zv. komandanti i FSK-së gjeneralmajor Enver Cikaqi, ishte në Aeroportin e Gjakovës për të ndjekur stërvitjen fushore “Kampi i Avancuar 2021”, të realizuar nga kadetët e Qendrës për Studime Universitare (QSU) të Forcës së Sigurisë të Ko-

sovës. Stërvitja përkatëse, si pjesë e programit akademik dhe profesional, është realizuar nga data 7 qershor dhe përfundoi më 18 qershor. Me këtë rast, ministri Mehaj u shpreh i kënaqur me përgatitjen e përgjithshme të kadetëve dhe me sukseset e QSU-së në përgjithësi. Ai theksoi se kjo stërvitje është një sfidë për të gjithë, dhe se performancën e demonstruar e vlerësoi lart duke i përgëzuar të gjithë për përmbyllje shumë

të suksesshme të këtij viti akademik. Gjithashtu ministri Mehaj potencoi se ndër synimet e tij është avancimi edhe më i madh i kapaciteteve të shkollimit ushtarak në të gjitha nivelet sipas standardeve më të avancuara të vendeve të NATO-s duke i inkurajuar të gjithë për angazhim dhe përkushtim sa më të lartë në studime në mënyrë që karriera ushtarake të realizohet me vetëbesim dhe kompetencë të lartë profesionale.


UNIVERSITETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

Diplomohen mjekët e parë të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Turqi

Në Universitetin e Shkencave Mjekësore, gjegjësisht në Fakultetin e Mjekësisë Güllhane, u mbajt ceremonia solemne e diplomimit, ku në mesin e 112 studentëve, u diplomuan edhe katër kadetë të FSK-së, të cilët pas gjashtë vitesh studimesh morën titullin Doktor i Përgjithshëm si dhe gradën ushtarake Nëntoger. I pranishëm në ceremoni ishte edhe Atasheu i Mbrojtjes në Ankara, kolonel Bekim Osmani, i cili në emër të ministrit të Mbrojtjes z. Armend Mehaj dhe të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, falënderoi dhe i shprehu mirënjohjen e lartë Rektorit të Universitetit të Shkencave Mjekësore për mbështetjen që ky institucion ka dhënë dhe vazhdon të japë për FSK-në. Me këtë sukses, FSK-së i shtohen kapacitetet profesionale mjekësore ushtarake në procesin e ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme të mbështetjes operacionale.

Gjermanët dhurojnë donacione me vlerë 210 mijë euro për FSK-në

Në kazermën “Skënderbeu” në Ferizaj, u mbajt ceremonia e prezantimit të donacionit të qeverisë gjermane dhuruar për FSK-në. Në ceremoninë përkatëse, ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, ku u pritën nga komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu. Në ceremoni të pranishëm ishin edhe zv. komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Jörg Rüter, komandanti i Komandës së Logjistikës, gjeneral brigade Naim Haziri dhe atasheu gjerman i mbrojtjes për Kosovën, nënkolonel Kai-Uwe Napel. Me këtë rast, ministri Mehaj falënderoi qeverinë gjermane për donacionin përkatës duke vlerësuar dhe shprehur mirënjohjen e thellë edhe për gjithë mbështetjen e deritashme në të gjitha fushat për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Ai theksoi se bashkëpunimi me Gjermaninë si një ndër partnerët kryesor në nivel të ministrive të mbrojtjes dhe forcave të dy vendeve do të rritet edhe më tej në fushat e interesit të përbashkët. Nga ana e tij, ambasadori Rohde, shprehu kënaqësinë e tij që në emër të qeverisë gjermane dhuron donacionin përkatës duke theksuar se bashkëpunimi në mes dy ministrive do të thellohet edhe më tej si dhe mbështetja nga shteti gjerman do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në fund nga ana e gjeneral Spahiut dhe nënkolonel Napel u ndanë certifikatat për personelin e specializuar për sistemin e frenimit të automjeteve të FSK-së. Donacioni përkatës përmban laboratorin e gjuhës gjermane dhe sistemin e frenimit të automjeteve si dhe trajnimin dhe certifikimin e personelit për këtë sistem me vlerën e përgjithshme prej 210 mijë euro. Kursi në gjuhën gjermane, që zhvillohet prej vitit 2017, me këtë laborator prej tani do të zhvillohet në kushte bashkëkohore dhe do të mundësojë përgatitjen më të efektshme të stafit gjermanisht-folës të FSK-së. Gjithashtu pajisjet e sistemit të frenimit do të mundësojnë flotë të sigurt dhe efektive të automjeteve të FSK-së.



Ministrja Shekerinska theksoi se anëtarësimi i vendit në Aleancë është një përfitim për sigurinë e të gjithë rajonit. Ajo tha se fillimi i procesit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Union do të forcojë vlerat europiane dhe do të lejojë që vendi dhe rajoni të vazhdojnë të zhvillohen në përputhje me vlerat europiane, dhe në të njëjtën kohë t'i japë fund përpjekjeve për ndikime të tjera jo-europiane.



Ministrja Shekerinska në Bratislavë, Sllovaki

Maqedonia e Veriut-Sllovaki: Mbështetje reciproke për aftësinë mbrojtëse

Maqedonia e Veriut dhe Sllovakia besojnë fuqimisht se uniteti i NATO-s sjell zhvillimin e aftësive të mbrojtjes dhe një angazhim të fortë për mbrojtjen kolektive

Janë hedhur bazat për intensifikimin e bashkëpunimit të mbrojtjes midis dy vendeve-aleate të NATO-s, Maqedonisë së Veriut dhe Sllovakisë, i cili do të zhvillojë kapacitetet kombëtare dhe ato të Aleancës për Mbrojtjen Kolektive. Anëtarësimi i plotë i Maqedonisë së Veriut në Aleancë ka forcuar sigurinë rajonale dhe tani është e nevojshme të bëhet hapi i shumëpritur dhe i merituar përpara në integrimin europian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky është përfundimi i takimit më 17 qershor 2021, në Bratislavë me Ministren e mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe homologun e saj Sllovak, Jaroslav Nad.

Ministrja Shekerinska theksoi se anëtarësimi i vendit në Aleancë është një përfitim për sigurinë e të gjithë rajonit. Ajo tha se fillimi i procesit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Union do të forcojë vlerat europiane dhe do të lejojë që vendi dhe rajoni të vazhdojnë të zhvillohen në përputhje me vlerat europiane, dhe në të njëjtën kohë t'i japë fund përpjekjeve për ndikime të tjera jo-europiane.

Ministri Nad shprehu mbështetje të hapur dhe të qartë për fillimin e negociatave të pranimit për Maqedoninë e Veriut, duke treguar se vendi ka përmbyshur atë që ka premtuar dhe se një vendim pozitiv i Bashkimit Europian do të konfirmojë besueshmërinë e procesit të pranimit.

Në kontekstin e bashkëpunimit të



mbrojtjes, Ministrat Shekerinska dhe Nad theksuan hapjen e të dy vendeve për intensifikimin e tij, duke pasur parasysh që të dy si Maqedonia e Veriut dhe Sllovakia besojnë fuqimisht se uniteti

i NATO-s, mbështetja e ndërsjellë në zhvillimin e aftësive të mbrojtjes dhe një angazhim i fortë për mbrojtjen kolektive janë themelet për të ruajtur sigurinë dhe prosperitetin në zonën euro-atlantike.

Radmilla Shekerinska - Frank Bake Jensen

Përvoja norvegjeze është e paçmueshme për forcat maqedonase



ndërtimin e integritetit dhe zhvillimin e Qendrës rajonale të marrëdhënieve me publikun, e cila është gjithashtu një qendër e certifikuar nga NATO, janë vetëm disa shembuj me të cilët të dy vendet tregojnë se si forcohet uniteti i NATO-s, përfunduan Ministrat Shekerinska dhe Bake Jensen. Takimi i ministrave të mbrojtjes u zhvillua

në prag të samitit të lidershit të Aleancës, i cili ishte thelbësor për zhvillimin e NATO-s. Tema kryesore e Samitit ishte iniciativa NATO 2030, forcimi i mbrojtjes kolektive, forcimi i rezistencës së shoqërive ndaj sfidave të reja dhe zhvillimi i teknologjisë që ka një ndikim në rritje në ndërtimin e aftësive të mbrojtjes.



Gjeneral Gjercinovski, në Bosnjë dhe Hercegovinë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm viziton misionin EUFOR

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Gjeneral Gjercinovski, ka zhvilluar një vizitë disa ditore në Bosnje dhe Hercegovinë, ku ka vizituar selinë e misionit EUFOR-ALTHEA në kampin Butmir në Sarajevë. Gjeneral Gjercinovski u takua me Komandantin e Misionit, Gjeneral Major Alexander Placer, ku ata diskutuan detyrat e misionit ALTHEA dhe kontributin maqedonas në misionin ku merr pjesë që nga Nëntori 2006. Pas takimit, delegacioni i udhëhequr nga gjeneral Gjercinovski vuri lule në memorialin e paqeruajtësve maqedonas të cilët vdiqën tragjikisht në rrëzimin e helikopterit 2008.


Gjatë vizitës në bazë, delegacioni pati një takim të shkurtër me përfaqësuesin maqedonas në mision, major Zlatko Danilov, i cili prezantoi gjeneralin Gjercinovski në më shumë detaje rreth detyrave të caktuara që ai kryen brenda misionit. Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore filloi të marrë pjesë në misionin EUFOR "ALTHEA" në korrik 2006 duke deklaruar një detashment helikopleri, i cili u forcua më tej nga një ekip mjekësor për mbështetjen mjekësore "ROLE 1". Gjatë pjesëmarrjes 15-vjeçare në operacionin paqeruajtës të BE-së, në përputhje me kërkesat, maqedonasit morën pjesë me staf, dhe me ndryshimin e strukturës së forcës në operacion nga dhjetori 2018, ata kontribuojnë në mision me një oficer shtabi.

Kontributi në operacionin ALTHEA është një konfirmim i angazhimit të fortë të Republikës së Maqedonisë Veriore për një kontribut të fortë në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Europian, si një konfirmim i përpjekjeve të përgjithshme të Republikës së Maqedonisë Veriore.

Më 12 janar 2008, ndodhi një përplasje tragjike helikopleri afër Katalanovo Blace, në të cilën 11 anëtarë të Ushtrisë humbën jetën gjatë kthimit nga një mision i përfunduar me sukses në BiH dhe të cilët ishin pjesë e rotacionit të tretë të shkëputjes së helikopterit.

Gjatë zhvillimit të Samitit të NATO-s, Ministrja e mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska u takua më 14 qershor 2021, me Ministrin e mbrojtjes të Norvegjisë, Frank Bake Jensen. Në takim u konfirmuan marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe të mbrojtjes midis dy vendeve. "Mbretëria e Norvegjisë ka treguar shumë herë se është miku dhe aleati ynë i vërtetë. Trajnimi i ekipit mjekësor maqedonas në Norvegji dhe pjesëmarrja e tyre në misionin në Afganistan dhe puna në spitalin norvegjez në Kabul është një shembull i bashkëpunimit aleat dhe zhvillimit të sigurisë kolektive. Maqedonia e Veriut deri në vitin 2028 duhet të zhvillojë aftësinë e NATO-s në formën e një ekipi kirurgjik që do të jetë në dispozicion si një burim i NATO-s. "Përvoja e fituar nga ekipi mjekësor ushtarak maqedonas, njohuritë që mori nga homologët e tij norvegjezë, janë të paçmueshme për atë qëllim," -tha Ministrja Shekerinska në takim.

Vendosja e suksesshme e për-bashkët e ekipit mjekësor ushtarak në Afganistan, mbështetja e vazhdueshme nga Norvegjia gjatë pandemisë, si dhe ndihma në



Ministri Panajotov vuri në dukje se zbatimi i aktiviteteve me interes të përbashkët kontribuon në ndërtimin e një bashkëpunimi afatgjatë dhe të frytshëm midis institucioneve të mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara, si bashkëpunim dypalësh dhe në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta për të zgjeruar dhe forcuar aftësitë e NATO-s.



Nisma të përbashkëta bullgaro-amerikane

Bullgari-SHBA: Bashkëpunim në kuadrin e “Dialogut Strategjik”

Ministri i Mbrojtjes i Bullgarisë, Georgi Panayotov bisedon dhe Ndihmës Sekretaren e Mbrojtjes së SHBA, Mara Carlin

Për bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes u diskutua nga Ministri i Mbrojtjes i Bullgarisë, Georgi Panayotov dhe Ndihmës Sekretarja e Mbrojtjes së SHBA, Mara Carlin.

Ministri i Mbrojtjes Georgi Panajotov zhvilloi një bisedë me video-konferencë me Ushtruesin e Detyrës Ndihmës sekretari amerikan i mbrojtjes për sigurinë ndërkombëtare Mara Carlin më, 22 qershor. Të dy diskutuan zhvillimin e bashkëpunimit dypalësh të mbrojtjes, duke riafirmuar natyrën e tij strategjike gjatë bisedimeve.

Ministri Panajotov vuri në dukje se zbatimi i aktiviteteve me interes të përbashkët kontribuon në ndërtimin e një bashkëpunimi afatgjatë dhe të frytshëm midis institucioneve të mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara, si bashkëpunim dypalësh dhe në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta për të zgjeruar dhe forcuar aftësitë e NATO-s.

Mara Carlin shprehu mirënjohje për politikën e qëndrueshme të Bullgarisë dhe përparimin e bërë në një numër fushash të bashkëpunimit në aspektin e mbrojtjes. Në këtë kontekst, ajo vuri në dukje gatishmërinë e palës amerikane për të ndihmuar Ministrinë Bullgare të Mbrojtjes në kapërcimin e sfidave ekzistuese.

Në fund të bisedës, u konfirmua dëshira e të dy palëve për të vazhduar të kërkojnë mundësi për të azhurnuar dhe zhvilluar nisma të përbashkëta të zhvilluara në kuadrin e Dialogut Strategjik midis Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara në fushën e mbrojtjes.



Iniciativa e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore

Bullgaria merr më 1 korrik 2021, kryesimin e SEDM-it

Mbi bazën e rotacionit, që nga 1 korriku 2021, Ministria e Mbrojtjes e Bullgarisë do të jetë kryetare e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM Process). Në përgatitje të marrjes dhe dorëzimit të mandatit, përfaqësuesit e kryesuesit e tanishëm që është Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, kanë zhvilluar një vizitë në Sofje më 18 qershor. Bisedimet janë përqendruar mbi thellimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe në vështirësitë e mbajtjes së takimeve të rregullta me prani për shkak të pandemisë. Ndërkohë është saktësuar edhe organizimi i ceremonisë së dorëzimit dhe pranimit të presidencës. Ajo do të jetë më 27 gusht të vitit 2021 në qytetin e Kumanovës të Maqedonisë së Veriut ku ndodhet Shtabi i Brigadës Shumëkombëshe të Europës Juglindore.



Certifikohen efektivë për misionin Althea në Bosnje-Hercegovinë

Certifikim i suksesshëm i formacioneve të Forcave Tokësore për Rezervën e Përkohshme të BE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë Althea. Ushtrimi taktiko-special i kompanisë mbi “Veprimet e një kompanie të mekanizuar për të ruajtur sigurinë në fushën e përgjegjësisë”, u mbajt nga 15 deri më 17 qershor në qendrën e trajnimit “Divdyadovo”- Shumen. Ushtrimi është pjesë e procesit të certifikimit të një kontingjenti të Forcave Tokësore në Rezervën e Përkohshme të Bashkimit European në Althea të Bosnjes dhe Hercegovinës. Kontingjenti përfshinte ushtarakë nga Batalioni i 29-të i Mekanizuar-Shumen, Brigada e 61-të e Mekanizuar-Karlovo dhe Regjimenti i 110-të i Logjistikës-Plovdiv.

Qëllimi i ushtrimit ishte të provonte aftësitë e ushtarakëve nga Elementi Mbështetës Kombëtar për planifikimin



e operacioneve dhe menaxhimit të formacioneve vartëse, si dhe testimin e njohurive dhe aftësive të personelit të ndërmarrjes së mekanizuar për organizimin dhe kryerjen e detyrave për të ruajtur sigurinë në zonën së caktuar.

Gjatë ushtrimit u demonstruan aftësi lidhur me organizimin dhe zbatimin e detyrave specifike si siguria dhe patrullimi; ndërtimi dhe ngritja e pikave të kontrollit; pikave të kontrollit; zmbarsjen e një sulmi në bazë;

evakuimi mjekësor dhe veprimet e formacioneve të reagimit të shpejtë.

Të gjitha fazat u vlerësuan nga një komision nga Komanda e Forcave të Përbashkëta dhe Forcat Tokësore të kryesuar nga Nënkolonel Valeri Ignatov në prani të një grupi kontrolli nga Shtabi i Mbrojtjes i kryesuar nga koloneli Pavel Mrankov. Elementi kombëtar i mbështetjes dhe kompania e mekanizuar u vlerësuan si “të gatshëm për luftime”.

Bullgaria duhet të përfitojë nga anëtarësimi në NATO

Unë nuk e shoh të ardhmen e NATO-s si një treg, por si një aleancë partnerësh të cilët punojnë së bashku për të zhvilluar teknologji, për të prodhuar pajisje ushtarake shumë efikase dhe për të demonstruar unitet”, -deklaroi Presidenti i Bullgarisë, Rumen Radev pas takimit të nivelit të lartë të vendeve anëtare të NATO-s, në Bruksel, më 14 qershor 2021. Udhëheqësit botërorë në Samitin e NASTO-s, miratuan strategjinë e aleancës deri në vitin 2030. Kreu i shtetit vuri në dukje se plani i NATO-s për zhvillim deri në vitin 2030 përcakton qëllime të larta. Ai shprehu kënaqësinë që plani përfshin masa për të kapërcyer mospërpjethjen teknologjike midis vendeve anëtare të paktit.

Presidenti bullgar Radev mirëpriti dy prej projekteve në “NATO 2030” për formimin e një organi civil-ushtarak për të stimuluar inovacionet në mbrojtje dhe për të krijuar një fond financiar për inovacionin. “Bullgaria duhet të punojë në mënyrë aktive në të gjitha drejtimet në mënyrë që industria, shkenca dhe të rinjtë tanë të ndjehen të plotë-vlefshëm dhe të përfitojnë nga anëtarësimi në NATO”, -tha ai.



ANCIENT ORIGINS

Hanibal Barka ishte një gjeneral kartagjenas që jetoi midis shekujve III dhe II Para Krishtit. Ai mbahet mend më shumë për fushatën e tij ushtarake kundër romakëve gjatë Luftës së Dytë Punike. Falë udhëheqjes së tij të shkëlqyer, kartagjenasit korrrën disa fitore të rëndësishme kundër romakëve, dhe patën sukses në pushtimin e pjesëve të Italisë së Jugut. Megjithatë ata nuk ishin në gjendje të arrinin një fitore vendimtare kundër Romës. Për më tepër, romakët e ndryshuan strategjinë e tyre në përballje me Hanibalin, dhe në fund ndërmorën një kundërsulm kundër Kartagjenës, gjë që çoi në fitoren e tyre.


Po kush ishte ky strateg i shkëlqyer ushtarak? Hanibali lindi në vitin 247 Para Krishtit në Afrikën e Veriut. Emri i tij, “Hanba’al” do të thotë “Mëshira e Ba’al”. Ba’al ishte një nga perënditë kryesor Punike. Hanibali ishte djali i madh i Hamilkar Barka, një gjeneral kartagjenas.

Në kohën e lindjes së tij, Kartagjena ishte në luftë me Republikën Romake. Kjo luftë, Lufta e Parë Punike, përfundoi me disfatën e Kartagjenës në vitin 241 Para Krishtit. Por Hamilkari nuk pushoi asnjëherë së pari romakët si armiq të tij, ndaj nisi një fushatë për të pushtuar Gadishullin Iberik.


Sipas historianit grek Polibi, megjithëse nuk ishte një sulm i drejt-përdrejt ndaj Romës, ajo fushatë synonte shtënien në dorë të burimeve të nevojshme për të zhvilluar një luftë tjetër kundër Republikës Romake. Në atë kohë Hanibali ishte vetëm 9-vjeç dhe i ati e mori me vete.

Në nëntë vitet që pasuan, Hamilkari zhvilloi një fushatë të suksesshme në Gadishullin Iberik, dhe kjo i dha mundësi Kartagjenës të ri-ngrihej sërish si një fuqi e frikshme në Mesdheun Perëndimor. Mbreti vdiq në vitin 229 Para Erës Sonë, kur Hanibali ishte ende i ri. Në fillim komanda supreme e ushtrisë dhe fushata e Kartagjenës kaloi në duart e dhëndrit të tij dhe kunatit të Hanibalit, Hasdrubal Panairi. Ndryshe nga Hamilkar dhe Hanibal, Hasdrubal përdori më shumë diplomacinë sesa fuqinë ushtarake për të nënshtruar armiq të Kartagjenës.

Madje ai arriti të negocionte një traktat paqeje me Romën, sipas të cilit, lumi Ebro do të formonte kufirin midis Kartagjenës dhe Romës në gadishullin Iberik.



Hanibali, gjenerali kartagjenas që tmerroi romakët



Por siç vëren historiani Tit Livi, “paqja nuk solli asnjë siguri”, pasi Hasdrubal u vra në vitin 221 Para Krishtit.

Pas tij në krye u vendos Hanibali, që në atë kohë ishte 26. Në fillim ai u fokusua në konsolidimin e pozitave të Kartagjenës në Gadishullin Iberik. Ai përdori diplomaci dhe forcoi marrëdhëniet me iberikët duke u martuar me Imilce, një princeshë vendase.

Ndërkohë ai e ndërthuri këtë diplomaci me metodat e përdorura nga babai i tij: forcën ushtarake për të nënshtruar

fiset e tjera Iberike. Në vitin 219, 2 vjet pas ngjitjes në pushtet, Hanibali ishte gati të sulmonte Republikën Romake. Por sulmi i tij i parë nuk ishte mbi vetë romakët, por mbi qytetin e lirë Saguntum. Rrethimi zgjati 8 muaj, gjatë të cilit Hanibali u plagos.

Romakët, që e konsideronin Saguntumin si aleat, e konsideruan sulmin e Kartagjenës ndaj qytetit të pavarur si një akt lufte. Por ata nuk i dhanë ndihmë ushtarake qytetit të rrethuar. Romakët dërguan në Kartagjenë një delegacion për të protestuar ndaj veprimit të Hanibalit. Kur qyteti ra pas 8 muajsh, të dërguarit romakë kërkuar dorëzimin e Hanibalit.

Kur kërkesat e tyre nuk u plotësuan, Roma i shpalli luftë Kartagjenës. Kështu, në viti 218 nisi Lufta e Dytë Punike. Hanibali mblodhi një ushtri për pushtimin e Italisë. Sipas Polibit, kjo ushtri përbëhej nga rreth 90.000 këmbësorë, 12.000 kalorës dhe 37 elefantë.

Meqenëse romakët kishin kontrollin e detit, Hanibali vendosi një pushtim tokësor të Italisë. Kjo do të thoshte që ushtria kartagjenase duhet të udhëtonte rreth 1.600 km për të shkuar nga Gadishulli Iberik në Itali. Përballë kishin 3 pengesa të frikshme natyrore malet Pirenej, lumin Rona dhe Alpet. Kalimi i Hanibalit në Alpe, mbahet mend si një nga veprimet ushtarake më të famshme të botës antike.

Polibit vëren se i gjithë marshimi zgjati 5 muaj. Historiani raporton se pasi kaloi Alpet, ushtria e tij u zvogëlua në rreth 20.000 këmbësorë dhe më pak se 6.000 kalorës, edhe për shkak të sulmeve nga disa fise vendase.

Edhe pse kishte humbur shumë njerëz, Hanibali arriti të zbriste në Italinë Veriore dhe të mposhte ushtrinë romake në perëndim të lumit Ticinus. Në dhjetor 218 para Krishtit, rreth 1 muaj më vonë, kartagjenasit mundën sërish ushtrinë romake në bregun perëndimor të lumit Trebia. Kjo fitore i bindi fiset lokale që t'i bashkoheshin kartagjenasve në luftën e tyre kundër Romës.

Hanibal vazhdoi marshimin e tij drejt jugut dhe shënoi një fitore tjetër në Betejën e Liqenit Trasimene në qershor 217 Para Krishtit. Por pas asaj fitoreje, Hanibali nuk marshoi menjëherë drejt Romës, ose sepse mendonte se trupat e tij ishin tepër të lodhura, ose sepse fortifikimet e Romës ishin shumë të forta.

Për më tepër, Hanibali shpresonte që aleatët italikë të Romës të kalonin në anën e tij. Prandaj, në verën e vitit 217, Hanibal pushoi në Picenum, duke i kufizuar fushatat e tij në sulmet lokale kundër Puljas dhe Kampanjës. Por romakët nuk pritën duarkryq.

Kuintus Verrukus u zgjodh diktator pas disfatës së Romës në Trasimene. Ai shmangu betejat në fushë të hapur, por



i ngacmoi vazhdimisht kartagjenasit me synimin që t'i shkatërronte. Në verën e 216, Hanibal marshoi sërish në jug dhe i shkaktoi një humbje shumë të rëndë romakëve në betejën e Kanaes. Ajo fitore bëri që shumë prej aleatëve italianë të Romës të kalonin me Kartagjenasit.

Por sërish, në vend se të shfrytëzonte mundësinë për të marshuar drejt Romës, Hanibali e kaloi dimrin e viteve 216-215 në Kapua. Ajo vonësi ishte fatale. Në vitet që pasuan, kartagjenasit hasën vështirësi të mëdha. Mbi të gjitha, ata nuk ishin në gjendje të shënonin një fitore vendimtare, pasi romakët i shmangnin në çdo rast betejat ballazi.

Inferioriteti numerik i ushtrisë së

Hanibalit, e bëri të vështirë shpërndarjen e ushtrisë në të gjithë gadishullin, për të ruajtur fitimet territoriale të arritura nga Kartagjenasit. Ushtria e Hanibalit po zvogëlohej dalëngadalë për shkak të vdekjes së njerëzve të tij, apo edhe dezertimit të aleatëve të tij Galikë, si dhe nga mungesa e përf forcimeve nga Kartagjena që nuk mbërritën kurrë.

Në këto kushte, romakët ndërmorën një sulm në Gadishullin Iberik, dhe patën sukses në dëbimin e kartagjenasve prej andej. Drejtuesi i kësaj fushate, Publius Shipioni, pushtoi nga atje Afrikën e Veriut, gjë që detyroi largimin e Hanibalin nga Italia në vitin 203 Para Krishtit.

Vitin pasues, Hanibali u përball me ushtrinë e Shipionit në Betejën e Zamës në Afrikën e Veriut dhe u mund nga ushtritë romake. Kartagjena nënshkroi një marrëveshje paqeje dhe Lufta e Dytë Punike mori fund vitin pasardhës.

Pavarësisht kërcënimit që Hanibali kishte paraqitur për Romën, ai nuk u ndëshkua nga romakët pas disfatës, duke u lejuar të vazhdonte të shërbente si një udhëheqës në Kartagjenë. Por Hanibali thuhet se kishte ofenduar pjesë të caktuara të fisnikërisë, pasi kundërshtoi praktikatat e tyre korruptive.

Si pasojë, ai u akuzua për nxitjen e Antiokut të III-të, sundimtarit të Perandorisë Seleukide në Mesdheun Lindor, për të nisur luftë ndaj Romës. Ndërsa disa historianë e kanë vënë në dyshim qëndrueshmërinë e kësaj akuze, të tjerë kanë argumentuar se Hanibali shpresonte të fillonte një luftë tjetër kundër Romës.

Në çdo rast, Hanibali shkoi të banonte në oborrin mbretëror Seleukid. Por pas disfatës së Antiokut përballë romakëve, fitimtarët kërkuar dorëzimin e Hanibalit. Prandaj, ish-gjenerali kartagjenas u arratis sërish duke përfunduar në oborrin e mbretit Prusias, sundimtarit

të Bitinisë, në Detin e Zi.

Romakët, ndikimi i të cilëve ishte rritur shumë në lindje, i kërkuar Prusias ta dorëzonte mikun e tij kartagjenas. Duke e kuptuar se bitinasit ishin gati ta tradhtonin, Hanibali kreu vetëvrasje duke pirë helm. Ai vdiq ndoshta në vitin 183 Para Krishtit. Pas vdekjes së Hamilkar Barkas në luftë kundër disa fiseve Iberike komandën në Hispani e mori dhëndri i tij Hasdrubali. Ky e zmadhoi Provincën e re të Kartagjenës dukshëm, themeloi qytetin e Kartagjenës si kryeqytet regional dhe lidhi me Romën Traktatin e Ebros. Ky Traktat thoshte se lumi Ebro është kufiri ndërmjet Romës dhe Provincës së re të Kartagjenës.

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Ushtritë ballkanike drejt Shqipërisë

Lufta e Parë Botërore (1914-1918) për Shqipërinë ishte një nga periudhat më të koklavitura dhe më të ngjeshura me ngjarje. Kjo periudhë është dhe më pak e studiuar nga historiografia e përgjithshme, por dhe ushtarake. Në truallin shqiptar shkelën dhe e pushtuan shtatë ushtri të huaja dhe e kthyen në zonë të operacioneve ushtarake ndërmjet grupimeve ndërluftuese.

Në fillim të tetorit 1915 Antanta zbarkoi në Selanik me kontingjente të vogla të ardhura nga fronti i Dardaneleve. Kontingjenti u quajt “Armata e Lindjes”. Kjo komandohej nga gjenerali francez Saraj. Ai mori Komandën e tre Divizioneve (Div. 57, 122 e 156). Në Selanik ndodhej dhe Div.10 Anglez. Qëllimi i tyre ishte kërcënimi i kufirit jugor të Bullgarisë, për t’u bashkuar gjatë Vardarit me ushtrinë serbe. Vardari në këtë kohë shërbente si linjë komunikimi dhe Selaniku quhej bazë operative. Por sido të paraqitej situata, serbët nuk duhej të largoheshin nga Gadishulli i Ballkanik. Ushtria serbe qëndresën fillimisht e bënë në brigjet e lumenjve Danub, Sava, Drina dhe më tej në zonën Valievo-Rudnik. Një armatë u caktua të luftonte forcat bullgare të cilat sulmuan nga lugina e Moravës, për të bashkëvepruar me forcat e Antantës e për të shkuar për ndihmë nga Selaniku në Shkup. Ushtritë e Bllokut Qendror, në fushatën kundër Serbisë u vunë nën Komandën e Mareshalit gjerman Makensen, i cili komandonte Armatën III Austriake dhe Armatën XI Gjermane. Ushtria bullgare kishte mobilizuar tre armata. Forcat mësymëse shkonin në rreth 500.000 vetë, ndërsa ushtria serbe me malaze shkonte në rreth 350.000 vetë nën komandën e Vojvodës Putnik. Qëndresa serbe në fillim ishte e fortë dhe e organizuar mirë, dhe përparimi bullgar ishte i ngadalë, kjo e ndikuar dhe nga gjendja e keqe e rrugëve për lëvizje. Ky ishte momenti kyç për bashkëveprimin midis trupave serbe dhe aleatëve të “Armatës së Lindjes”. Forcat bullgare me manovër të shkathët e të fuqishme dolën në prapavijë të serbëve. Ato prenë rrugën e bashkimit, si dhe të tërheqjes së “Armatës së Lindjes”. Përpjekjet e “Armatës së Lindjes” ishin të kota. Në kampin e Antantës u dha sinjali për të shpëtuar serbët.

Por, e vetmja rrugë shpëtimi për ushtrinë serbe ishte nëpërmjet Shqipërisë, nga portet e saj të Shëngjinit, Durrësit dhe Vlorës. “Armata e Lindjes” u tërhoq në Selanik, në transhetë të cilat i fortifikoi dhe prej tyre doli shumë vonë. Për qëndrimin e trupave aleate në Selanik u zhvillua një debat i ashpër. Anglia kërkonte tërheqje, ndërsa Franca kërkonte qëndrimin e tyre dhe ja arriti qëllimit. Trupat ushtarake gjermano-bullgare përparuan në drejtim të Selanikut, por arsyet politiko-ushtarake i ndalën në kufirin grek. Qeveria greke vazhdonte t’i premtojte Serbisë për ndihmë ushtarake, sipas traktatit të Aleancës serbo-greke. Kështu, ajo nuk bëri vetë as përpjekjen më të vogël dhe i pengoi trupat e Aleatëve dhe favorizoi Fuqitë Qendrore. Greqia jo vetëm që nuk e bëri këtë, por e lodhur nga presionet e Serbisë më 10 tetor i bëri të ditur qeverisë serbe se refuzonte në mënyrë kategorike t’i jepte ndihmën ushtarake. Pas disfatës së ushtrisë serbe, në fund të vitit 1915 në Ballkan raporti i forcave ndryshoi. Fronti i veprimeve luftarake po zhvendosej drejt

Pushtimi i Shqipërisë nga fqinjët gjatë Luftës së Parë Botërore



Jugut të Ballkanit, në Shqipëri. Në këtë periudhë kemi vendosjen e një ekuilibri të ri, por me elemente të vjetër.

Bloqet ndërluftuese në Shqipëri

Me fillimin e konfliktit botëror, kjo mbështetje u bashkërendua me diplomacinë e vendeve të Antantës, si dhe në drejtim të Italisë. Për Italinë, Vlora përbënte çelësin e Adriatikut. Ndaj dhe presidenti i Republikës franceze R. Puankare i propozoi përfaqësuesit rus në Francë, A. Izvolskit, se duke i dhënë Italisë Vlorën dhe duke lënë dorë të lirë në Shqipëri, do ta tërhiqnin atë në anën e tyre. Me propozimin e francezëve për dhënien e Vlorës Italisë ishin edhe Rusët e Anglezët. Edhe italianët ishin të përgatitur për realizimin e objektivave me mjete ushtarake. Anglezët ishin më pak të avancuar dhe kërkonin siguri të plotë për futjen e Italisë në luftë në anën e tyre. Ndërsa Italia e kërkonte këtë siguri nga vendet e Antantës, qëllimi për plaçkën pas përfundimit të luftës. Ndaj dhe më 26 prill 1915 u nënshkrua Traktati i Fshehtë i Londrës. Nënshkrimi i këtij traktati bëri që gjendja në Shqipëri të keqësohej dhe të rrezikoej ekzistenca e saj. Pozita e jashtme e Shqipërisë përcaktohej nga Traktati i Londrës dhe e brendshme nga pushtimi i huaj.

Qeveria Italiane u bashkua me Antantën për ndarjen e tokave shqiptare midis shteteve ballkanike, por Vlorën nuk do ta lëshonte në asnjë mënyrë. Kjo ishte e shprehur nga F. Martini ministri i kolonive ashtu edhe Titoni në projektin e 25 shtatorit, sepse për italianët Vlora kishte dhe në të ardhmen rëndësi strategjike. Edhe Austro-Hungaria territoret shqiptare do t’i përdorte për realizimin e interesave të saj politiko-ushtarake. Duke nxitur Malin e Zi përpara fushatës me Serbisë për të mbajtur asnjanshinë, i premtoi Shkodrën dhe një pjesë të Shqipërisë së Veriut. Mali i Zi mendonte të realizonte qëllimet ndaj Shqipërisë në rrugë tjetër. Ai

i shpalli luftë Austro-Hungarisë më 6 gusht, duke përmbysur shpresat e Perandorisë. Qeveria e Vjenës i dinte kontradiktat midis Shqipërisë dhe shteteve sllave, ndaj u mundua që t’i shfrytëzonte për qëllimet e saj. Shefi i Shtatmadhorisë së ushtrisë austro-hungareze në janar 1914 ishte shprehur për përdorimin e Shqipërisë në realizimin e planeve politike dhe ushtarake të tyre. Ai theksonte se duhej të forcohej Shqipëria, për të neutralizuar Forcat e Armatosura serbo-malazeze. Ndaj dhe i propozoi ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë Leopold Bertholdit për krijimin e ushtrisë shqiptare, me kusht bashkëveprimi me Monarkinë. Ai mendonte se Shqipëria i realizonte interesat e saj, jo duke ndenjur neutrale por në marrëdhënie të ngushta politike dhe kulturore me Monarkinë dhe aleancat me të. Pozita e Shqipërisë dhe objektivat politiko-ushtarake të Antantës dhe Bllokut Qendror ishte se territori i saj dhe veçanërisht Vlora dhe në vitet e tjera të luftës kishin një rëndësi të veçantë veçanërisht për dy fuqitë e Adriatikut. Ndaj tokat shqiptare u bënë pre e lakmive të shteteve ballkanike, të Italisë, të Austro-Hungarisë etj.

Pushtimi i territoreve shqiptare

Për konkretizimin e planeve dhe qëllimeve, shtetet si Greqia, Italia, Serbia, Mali i Zi kaluan në veprime ushtarake pushtuese në Shqipëri. Në sulm u hodh e para Greqia, e cila pushtimin e Shqipërisë së Jugut e bëri me miratimin e të dy blloqeve ndërluftuese. Ky pushtim prej Greqisë ishte thjesht formal, sepse Forcat e Armatosura greke ishin të pranishme në Shqipërinë e Jugut, të maskuara në ushtrinë “autonomiste”. Dhe konsujt e huaj në Janinë e në Korfuz kishin njoftuar vazhdimisht qeveritë e tyre. Mjetet e propagandës greke theksonin pushtim të “përkohshëm”. Këtë çështje e mbylli lëvizja e trupave dhe zëvendësimi i forcave “autonomiste” e

kthimi i tyre në ushtri të rregullt.

Me pushtimin e Jugut të Shqipërisë mori fund dhe shteti autonom i “Vorio-Epirit”, i cili kishte sjellë dëme njerëzore e materiale të popullsisë. Në fund të tetorit 1914, Italia i filloi veprimet e saj pushtuese në territorin e Shqipërisë. Ajo dërgoi një kontingjent të vogël ushtarak në ishullin e Sazanit. Në Vlorë fillimisht erdhi një “mision sanitar” që drejtohej nga një nënkolonel, për të kontrolluar situatën. Dërgimi i forcave ushtarake në Vlorë, sipas gjeneralit Kadorna, ishte e pa këshillueshme. Italianët donin të merrnin Vlorën pa ndonjë rezistencë, si dhe prisnin një situatë të përshtatshme dhe pa ndonjë incident.

Anijet ushtarake italiane që patrullonin në ujërat pranë Vlorës, bënëin kujdes duke mbrojtur idenë e Kadornës dhe filluan në mënyrë graduale rritjen e forcave. Konsulli italian në Vlorë, theksonte se me dy batalione, nuk ishte i këshillueshëm pushtimi i Vlorës. Italia ishte e shqetësuar në lidhje me zhvillimin e situatës ndërkombëtare në rajonin e Mesdheut. Në këtë kohë Turqia doli nga neutraliteti dhe u afrua me Bllokun Qendror. Ajo hyri në luftë kundër fuqive të Antantës më 1 nëntor. Qeveria Italiane në këtë situatë vendosi që anijet luftarake të saj të kontrollonin ujërat bregdetare të Shqipërisë. Kështu Italia po përforconte pozitat e saj dhe po krijonte pikëmbështetje detare e tokësore në Gjirin e Vlorës. Pushtimi i Vlorës u bë më 25 dhjetor 2014, ku ushtarë italian zbarkuan në Skelë. Këto forca ishin të barabarta me një batalion të marinës italiane. Armatim i tyre ishin topa dhe mitraloza, dhe pas disa ditësh zbarkon në Vlorë dhe Regjimenti Bersalierëve, duke arritur në 2 mijë ushtarë. Pushtimi i Vlorës u shoqërua dhe me zgjerimin e zonës së pushtimit në periferi të saj. Serbia në qershor 1915 pushtoi Shqipërinë e Mesme dhe Mali i Zi Veriun e saj. Ajo kishte bërë një përqendrim të forcave të ushtrisë në kufirin shqiptar dhe këto forca shkonin nga 10 deri 20 mijë ushtarë. Këto komandoheshin nga gjenerali Damian

Popoviçi, një ultrashovinist i shoqërisë “Dora e zezë”. Në historinë e ushtrisë serbe këto forca janë quajtur “Ekspedita shqiptare”. Grupimi ushtarak i forcave serbe përbëhej nga grupimi i Prizrenit, i Drinit dhe i Ohrit. Këto grupime kaluan në sulm në kufirin shqiptar në tre drejtime të rëndësishme dhe depërtuan në thellësi të vendit. Pushtimi serb u bë në kundërshtim me objektivat e Fuqive. Komanda serbe u përpoq të justifikonte pushtimin, me pretekstin se bënte sigurimin e krahëve të Shqipërisë. Pushtuesi serb arriti deri në veri të lumit Shkumbin, duke iu përmbajtur marrëveshjes së majit 1913 me Greqinë, ku vija ndarëse në Shqipëri ishte lumi Shkumbin midis tyre. Ndërsa në këtë kohë edhe ushtria malazeze filloi më 8 qershor, operacionet ushtarake për pushtimin e Shqipërisë së Veriut, me një forcë rreth 6-7 mijë ushtarë. Edhe veprimi i Malit të Zi nuk mori miratimin e Antantës, por pushtimi nis që ditën e parë me dy kolona, e para në drejtim të Gashit dhe të Bytyqit dhe e dyta në drejtim të Kelmendit dhe të Taraboshit. Me rënien e malit të Taraboshit më 10 qershor, ushtria malazeze arriti në dyert e Shkodrës, por ajo nuk hyri brenda në qytet. Qeveria e Cetinjes, u mundua të shpjegonte pretekstin e pushtimit për sigurimin e furnizimit të Malin e Zi nëpërmjet Shëngjinit dhe lumit Bunë, pasi shqiptarët e rrezikonin në mënyrë të vazhdueshme.

Historiografia ushtarake malazeze është përpjekur në vijimësi të “argumentojë” se pushtimi i Shqipërisë së Veriut prej tyre “nga pikëpamja ushtarake ishte i drejtë” ndërsa për Italinë dhe Greqinë, ato “dhunuan asnjanshinë e Shqipërisë pa arsye”. Pushtimi i Shqipërisë prej ushtrive serbe e malazeze, bëri që ushtria greke të zgjeronte zonën e pushtimit duke arritur deri në afërsi të Beratit. Kjo gjendje pushtimi në Shqipëri nuk vazhdoi gjatë. Pushtuesit serbë, malazezë e grekë u zëvendësuan nga pushtues të tjerë dhe territori shqiptar u bë shesh beteje nga të dy grupimet ushtarake më të mëdha të kohës.



MINISTRI I MBROJTJES, NIKO PELESHI

Ushtarakët pastrojnë inertët, bëjnë gati Sazanin për pushuesit

“Ministria e Mbrojtjes është e angazhuar në të gjithë bregdetin e vendit për pastrimin dhe lëvizjen e inerteve. Sot ishte radha e Sazanit, ku bashkë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe të rinj vullnetarë pas-truam brigjet e ishullit për t'i hapur rrugë sezonit turistik atje”, -shkruan Peleshi. Kurse ministri i Turizmit, Blendi Klosi shkruan se “Pastrimi, kryefjala e sezonit turistik të këtij viti. Hapja e kufijve dhe lëvizja e lirë drejt vendeve të BE-së do të rikthejë gjallërinë e turizmit në Vlorë dhe në të gjithë Shqipërinë”.

